

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT TË POLICISË SË SHTETIT PËR VITIN 2021



REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E BRENDSHME

www.mb.gov.al

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT TË POLICISË SË SHETIT PËR VITIN 2021

Plani i Integritetit për organizatën e Policisë së Shtetit është një dokument strategjik dhe operacional, që synon forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në radhët e policisë. Ky plan u hartua mbi bazën e analizës së faktorëve të rrezikut që cenojnë integritetin dhe është një dokument që rikonfirmon përpjekjet e Policisë së Shtetit për të pasur një organizatë të shëndetshme, që t'i shërbejë publikut dhe gjithë komunitetit në përmbushje të objektivave e parimeve mbi bazën e të cilave udhëhiqet organizata.

Plani i Integritetit dhe Plani i Veprimit në zbatim të tij u hartua në përputhje me dispozitat e ligjit 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* i ndryshuar, dispozitat e Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM-në nr. 750/2015 (ndryshuar), Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj, Objektivi A.8 *“Përdorimi sistematik i evidentimit të hapësirave për korrupsion”* dhe A.9 *“Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë”*, në të cilat sanksionohet se *“Plani i Integritetit do të sigurojë kuadrin konceptual për politikën dhe masat që duhet të merren me qëllim parandalimin e shkeljeve të integritetit nga ana e zyrtarëve publikë dhe për monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në një institucion publik”*.

Për arritjen e objektivave të forcimit të sundimit të ligjit, forcimit të integritetit, të vlerave dhe standardeve etike e profesionale të çdo punonjësi e strukture policie, plani përcakton masa konkrete, bazuar në një analizë të hollësishme të fushave e aktiviteteve në risk që cenojnë integritetin dhe rrezikojnë përfshirjen në korrupsion.

Plani i Integritetit është bazuar në rezultatet e një pune të iniciuar që në vitin 2019, nga përfaqësues të Policisë së Shtetit me mbështetjen e Partnerëve të Projektit PAMECA V dhe DCAF. Ndërsa një grup punë i Drejtorisë së Standardeve Profesionale në DPPSH, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat dhe Ministrisë së Brendshme, finalizuan këtë dokument të rëndësishëm.

Plani i Integritetit përmban:

- Fushat dhe aktivitetet e ekspozuara ndaj korrupsionit me risk për cënueshmërinë e integritetit.
- Planin e Veprimit, në të cilin përshkruhen masat që do të merren, afatet, si dhe strukturat përgjegjëse që do të kryejnë aktivitetet e përcaktuara.

Ky Plan i grupon aktivitetet që do të zhvillohen në gjashtë fusha të identifikuar si të ekspozuara ndaj riskut të integritetit, të cilat kanë të bëjnë me:

- Korrupsionin në strukturat e hetimit të krimet;
- Korrupsionin burokratik në burimet njerëzore;
- Korrupsionin në nivelin e ulët ose i ashtuquajturin korrupsionin i rrugës;
- Korrupsionin burokratik në menaxhim;
- Korrupsionin burokratik në prokurimin publik;
- Dekurajimin e “kulturës së heshtjes” dhe inkurajimin e denoncimit të veprimeve korruptive duke shfrytëzuar dhe mundësitë që ofron ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Pas miratimit me urdhër nr. 331, datë 12.10.2020 të Ministrit të Brendshëm u shpërnda në të gjithë strukturat qendrore e vendore për njohje.

Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Planin e Integritetit të Policisë së Shtetit dhe Planin e Veprimit 2020-2021, me shkresën nr. 52, datë 12.01.2021 “Për hartimin dhe raportimin mbi Planin e Integritetit”, ju kërkua të gjitha strukturave qendrore dhe vendore të PSH, hartimi i detyrave të tyre duke përfshirë, aktivitetet dhe masa për çdo strukturë e shërbimit policor, në varësi me kushtet dhe problematikat e çdo strukture, aktivitetet të cilat u planifikuan me shtrirje gjatë gjithë vitit 2021, duke ndjekur me prioritet zbatimin e tyre sipas indikatorëve matës.

Në muajin mars 2021, u organizua një ceremoni në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në të cilën projekti PAMECA V dorëzoi 300 kopje të broshurës “Plani i Integritetit për Policinë e Shtetit 2020-2021”, të cilat u shpërndanë në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit.

Aktualisht ka përfunduar raportimi për vitin 2021, Raportime që janë administruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, e cila është ngarkuar përveç përmbushjes së detyrimeve të monitorimit dhe me analizimin e raportimeve nga strukturat.

Në kuadër të implementimit të Planit të Integritetit të Policisë së Shtetit është hartuar “Raporti mbi zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2021, në Policinë e Shtetit”. Ky informacion ka pasqyruar zbatimin e masave të ndërmarra nga të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit për të gjitha fushat dhe aktivitetet e parashikuara në Planin e Integritetit dhe Planin e Veprimit 2020-2021 në Policinë e

Shtetit. Ky informacion ka pasqyruar zbatimin e masave të ndërmarra nga të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit, për të gjitha fushat dhe aktivitetet e parashikuara në Planin e Integritetit dhe Planin e Veprimit 2020-2021 në Policinë e Shtetit dhe është publikuar një përmbledhje ekzekutive në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit (<https://www.asp.gov.al>), dhe mund të aksesohet në këtë link <https://www.asp.gov.al/plani-i-integritetit-te-policise-se-shtetit/>.

Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2021, në Policinë e Shtetit në mënyrë të detajuar ka pasqyruar zbatimin e masave të ndërmarra nga të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit për të gjitha fushat dhe aktivitetet e parashikuara në Planin e Integritetit dhe Planin e Veprimit 2020-2021, në Policinë e Shtetit. Ky informacion pasqyrohet me statistika, për masat disiplinore, inspektimet dhe masa penale. Për hartimin e këtij informacioni është bashkëpunuar në vazhdimësi me SHÇBA.

Si më poshtë të dhënat statistikore mbi këtë raport:

Në përmbushje të detyrave funksionale, nga strukturat përkatëse të PSH (DPS) janë kryer inspektime, monitorime, verifikime, hetime disiplinore, kontrole dhe intervistime ndaj punonjësve të strukturave dhe shërbimeve të policisë me uniform/shërbimit të patrullës së përgjithshme, të policisë rrugore, të kufirit/në pikat e kontroll kufirit kufitar, specialistëve të hetimit të krimit, si dhe për ngjarje e raste të bëra publike në median e shkruar dhe elektronike nga ku për mangësitë e konstatuara në drejtim të shkeljeve ligjore, zbatimit të parimeve dhe normave të etikës profesionale, rregullave të komunikimit me qytetarët gjatë ushtrimit të detyrës, të shkeljeve ligjore gjatë shoqërimit, arrestimit e ndalimit, hyrjeve e daljeve në pikat e kontroll kalimit kufitar etj.

Gjatë vitit 2021, nga Drejtoria e Standardeve Profesionale janë zhvilluar 83 vlerësime performance e monitorime (23 vlerësime të zakonshme dhe 60 vlerësime të jashtëzakonshme e trajtim ankesash) me përfshirjen e rreth 197 strukturave policore në nivel Departamenti, Drejtorie, Komisarjati, Stacioni, apo Seksioni Policie. Krahasuar me vitin 2020, ku janë kryer 89 vlerësime performance (19 vlerësime të zakonshme dhe 70 vlerësime të jashtëzakonshme e trajtim ankesash) me përfshirjen e 209 strukturave policore në nivel Drejtorie, Komisarjati, Stacioni, Sektori apo Seksioni Policie.

Në bashkëpunim me SHÇBA, gjatë vitit 2021 nga konstatimet e strukturave qendrore e vendore, nga inspektimet e kryera nga Drejtoria e Standardeve Profesionale dhe SHÇBA janë identifikuar, hetuar e ndëshkuar me masa disiplinore gjithsej 766 punonjës policie.

Referime pranë Prokurorive të shkallës së parë dhe SPAK:

- Referime të reja janë dërguar pranë organit të Prokurorive të shkallës së parë:
 - 88 punonjës policie i nivelit të parë drejtues;
 - 223 punonjës policie të nivelit zbatues.

- Masa e sigurimit personal “arrest në burg”:
 - 9 punonjës policie të nivelit të parë drejtues;
 - 2 punonjës policie të nivelit zbatues.

- Masa e sigurimit personal “arrest shtëpie”:
 - 1 punonjës policie të nivelit të parë drejtues;
 - 2 punonjës policie të nivelit zbatues.

- Masa e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”:
 - 2 punonjës policie të nivelit të parë drejtues;
 - 11 punonjës policie të nivelit zbatues.

- Masa e sigurimit personal “pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”:
 - 10 punonjës policie të nivelit të parë drejtues;
 - 17 punonjës policie të nivelit zbatues.

Gjatë vitit 2021 janë proceduar penalisht punonjës policie të dyshuar për kryerjen e veprave penale si :

- Shpërdorim detyre/kultivim i bimëve narkotike 34 punonjës policie;
- Shpërdorim detyre/favorizim ndërtime pa leje 18 punonjës policie;

- Shpërdorim detyre duke favorizuar kontrabandë kalim të paligjshëm të kufirit dhe trafik droge 38 punonjës policie;
- Kryerje e veprimeve arbitrare 30 punonjës policie
- Dëmtime të tjera me dashje, dhunë në familje goditje për shkak të detyrës 34 punonjës policie;
- Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor dhe drejtim mjete në mënyrë të parregullt 25;
- Ushtrim i ndikimit të paligjshëm 2 punonjës policie;
- Shkatërrim prone 4 punonjës policie;
- Mashtrim, kallëzim i rremë 2 punonjës policie;
- Shpërdorim detyre, korrupsion pasiv 123 punonjës policie.

Për të gjitha këto raste është mbajtur qëndrim në zbatim të rregullores duke i pezulluar nga detyra me dhe pa pagesë sipas statusit të tyre në zbatim të nenit nr.222, pika 3, germa b, c, d të Rregullores së Policisë së Shtetit si dhe është bashkëpunuar me SHÇBA-në dhe Prokurorinë në të gjitha rastet, kur është provuar me prova dhe fakte përgjegjësia e këtyre punonjësve. Krahas hetimit penal është kryer dhe hetim administrative dhe janë marrë masa disiplinore deri në përjashtim nga Policia e Shtetit.

Në lidhje me shkeljet disiplinore të konstatuara përsa I përket zbatimit të normave që kanë të bëjnë me kërkesat e Kodit të Etikës së Policisë së Shtetit, sjelljen dhe performancën e punonjësve të policisë për vitin 2021, janë dhënë 35 masa disiplinore:

- | | |
|--|---------------------|
| - “Përjashtim nga Policia”, | 1 punonjës policie |
| - “Shtyrje e afatit të gradimit deri në dy vjet” | 27 punonjës policie |
| - “Masa e lehtë disiplinore” | 6 punonjës policie |
| - “Mbajtja e pagës në masën 5 ditë pune” | 1 punonjës policie |

Me qëllim hartimin e Planit të ri të Integritetit është ngritur grupi i punës me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.131, datë 02.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit të Policisë së Shtetit, për periudhën 2022-2024”. Raporti i Vlerësimit i Planit të Integritetit 2021-2022 do të shërbejë si analizë për të hartuar Planin e ri të Integritetit të Policisë së Shtetit.